



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:087908

Datë: 17.05.2024

Numri i dokumentit: 05738759

KA.nr.675/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “Grupi Koha” ShPK me NUI 810508955 dhe seli në bulevardin Xhorxh Bush p.nr. në Prishtinë, i cili sipas prokurës përfaqësohet nga avokatët Arianit Koci, Granit Vokshi dhe Nora H. Veliu me seli në rrugën Robert Doll nr. 34 në Prishtinë kundër të paditurit Komisioni i Pavarur për Media me seli në Prishtinë, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 03.05.2024 në të cilën morën pjesë përfaqësuesit e palëve, më 17 maj 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “Grupi Koha” ShPK me NUI 810508955, ndaj të paditurit Komisioni i Pavarur për Media me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. 11/2021 të datës 12.03.2021 të së paditurit.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 07.05.2021 e ka iniciuar konfliktin administrativ me kërkesë për anulimin e vendimit nr. 11/2021 të datës 12.03.2021 të së paditurit Komisioni i Pavarur për Media dhe kthimin e lëndës në rivendosje.
2. Ai në padi por edhe gjatë procedurës ka pretenduar se vendimi i goditur përshkruhet me të meta në aspektin formal dhe përmbajtësor, të cilat mund të vërehen me anë të një leximi sipërfaqësor të tij. Në këtë drejtim ka shtuar se arsyetimi i vendimit është i përfshirë në mangësi të paraparë me nenin 48 të LPPA-së sepse thëniet e tij nuk janë marrë fare parasysh, ndërsa lidhur me këto raste kur arsyetimi i një vendimi është i mangët, ligjvënësi i ka sanksionuar në nenin 52 dhe rrjedhimisht në bazë të këtyre

dispozitave vendimi i të paditurës duhet të shpallet si i paligjshëm meqë i njëjti karakterizohet apo përfshihet në shkeljet e thëna. Sipas tij, i Padituri fare nuk ka marrë parasysh faktin se nuk kishte pasur komunikim publik në atë program i cili ka bërë thirrje për votim as numër të partisë që do të mund të konsiderohej se është paraqitur për të bërë thirrje për votim e që do të mund të cilësoheshin, si promovime zgjedhore të cilat rregullorja për komunikimet komerciale audio-vizuale i ndalon që të realizohen jashtë kohës së fushatave, rrjedhimisht, nëse një parti shfaqet përmes një video në një program televiziv pa kërkuar vota, ose pa promovuar numrin e saj të zgjedhjeve zakonisht nuk konsiderohet sponsorizim për të promovuar votimin, e që pastaj të konsiderohet e ndaluar në bazë të nenin 14.5 të rregullores në fjalë. Në lidhje me këtë ka shtuar se, mungesa e këtyre elementeve lë që të kuptohet se neni 14.5 nuk gjen këtu aplikueshmëri.

3. Përveç kësaj, ai ka shtuar se i Padituri mundohet që të konsiderojë pa të drejtë atë video të shfaqur si promovim zgjedhor, i njëjti nuk ka qenë i tillë ngase nuk ka pasur qëllim thirrjen e publikut për votim të asaj partie dhe po ashtu, ka munguar numrat e partisë. Sipas tij, pika 5 e nenit 14 parasheh që partitë politike nuk do të jenë sponsorë të programeve audi-vizuale në një elaborim të dispozitës duke u bazuar në të njëjtën rregullore termi 'program audio-vizual' i referohet kryesisht shembujve të transmetimit televiziv si filmi i metrazhit të gjatë, ngjarjeve sportive, komedive, dokumentarëve etj., rrjedhimisht lirshëm mund të konkludojmë se nuk kemi një sinkronizim mes hapësirës të cilën e ka sponsorizuar partia politike me atë çka vet rregullorja në terminologjinë e përcaktuar nga ajo i referohet si 'program', çka do e përjashtonte KTV-në nga shkelja e dispozitës përkatëse.
4. I padituri në përgjigje e tij në padi e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e Paditësit dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj atë si të pabazuar. Ai ka pretenduar se emision i shfaqur nga Paditësi që ka qenë kryekëput politik, i cili ka transmetuar subjektin politik të PDK-së, ku është parë logo e partisë, slogani si dhe listat e kandidatëve për zgjedhje. Në lidhje me këtë ka sqaruar se kjo është një shkelje e qartë e paraparë në nenin 14.5 të Rregullores për Komunikime Komerciale, e cila përcakton se partitë politike nuk do sponsorizojmë program përveç gjatë kohës së promovimit zgjedhor, ndërsa programi në fjalë është transmetuar para fillimit të fushatës zgjedhore. Më tutje ka shtuar se vendimi i goditur është në pajtueshmëri të plotë me LPPA-në, i cili përmban pjesën hyrëse, diapozitivin dhe arsyetimin dhe pjesën përmbyllëse të vendimit, është marrë në

bazë të autorizimeve ligjore dhe është në pajtueshmëri të plotë me dispozitat ligjore materiale dhe procedurale.

5. Për fund ka deklaruar se interpretimi i termit program është i nxjerrë vetëm nga shembujt e dhënë, në përkufizimin e këtij termi, sepse termi “Program” nënkupton një pako e fotografive lëvizëse me ose pa zë, që përbën një njësi të vetme brenda orarit ose katalogëve të programeve të vendosura nga ofruesi i shërbimit medial, forma e të cilit është e krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit televiziv, që do të thotë transmetimi i atij programi para fushatës është shkelje e pastër e Rregullores për Komunikime Komerciale.

II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

6. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: vendimi nr.11/2021 me nr. protokollit ref.2103/364/BA/YF i datës 22.03.2021 si dhe komplet shkresat e lëndës të procedurës administrative të cilat i Padituri i ka dorëzuar në përgjigjen në padi në bazë të nenit 37.2 lidhur me nenin 43.1 të LKA-së.
7. Gjykata pas analizimit të provat të cekura më lartë në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe duke i zbatuar rregullat e të provuarit nga neni 322 i LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së e konstatoi gjendjen faktike të përshkruar më poshtë.
8. I Padituri nga data 17.01.2021 deri më 02.02.2021 kishte monitoruara programet televizive ndërmjet orës 16:00 deri 24:00 të operatorëve të shërbimeve mediale audiovizuale me qëllim të vlerësimit të përputhshmërisë së tyre me Rregulloren 2017/07 për Komunikimet Audiovizuale (këtu e tutje Rregullorja). Gjatë atij monitorimi, i Padituri kishte gjetur se Paditësi më 17.01.2021 nga ora 18:05:18 për 22 minuta e 43 sekonda kishte shfaqur një program audiovizuel në lidhje me partinë politike PDK, i cili ishte theksuar si i sponsorizuar. I Padituri gjithashtu kishte vërejtur se gjatë atij programi ishte shpalosur programi politik i PDK-së, shiheshin logoja dhe slogani i asaj partie politike, si dhe ishte publikuar lista e kandidatëve për zgjedhjet e ardhshme.
9. Duke u bazuar në konstatimet e cekura më lartë, i Padituri më 11.02.2021 kishte dhënë vendimin me numër të protokollit ref. 2102/163/KPM/xhl, me të cilin Paditësit i kishte shqiptuar vërejtje.

10. Më 08.03.2021 Paditësi kishte ushtruar ankesë ndaj vendimit të cekur më lartë, ndërsa i Padituri përmes Bordit për Ankesa më 22.03.2021 kishte dhënë vendimin e goditur nr.11/2021, me të cilin e kishte refuzuar ankesën e Paditësit dhe e kishte vërtetuar vendimin e shkallës së parë.
11. Nuk ishte kontestuese ndërmjet ndërgjyqësve se Paditësi në datën dhe kohën si më lartë kishte transmetuar një program, në të cilin shihej partia politike PDK duke e shpalosur programin e saj politik dhe listën e kandidatëve të saj për zgjedhje, në të cilin gjithashtu shihej logoja dhe slogani i asaj partie, si dhe se ai program ishte i sponsorizuar ajo parti politike.
12. Kontestuese mes palëve ishte se a paraqet shfaqje e tillë “program”, si dhe pasoja juridike e shfaqjes së programit të tillë, gjegjësisht a paraqet veprimi i tillë shkelje nga neni 15 para. 4 i Rregullores.

III. Vlerësimi meritor i rastit

13. Gjykata në rend të parë e shqyrtoi se a ka pasur kompetencë i Padituri për ta dhënë vendimin e goditur dhe gjeti se në bazë të nenit 30 para. 1, 36 dhe 44 të Ligjit 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Media (këtu e tutje LKPM) ka pasur autorizim ligjor për ta dhënë vendimin e goditur. Në këtë drejtim, gjykata vëren se nga Paditësi nuk ishte ndritur asnjë pretendim i kësaj natyre.
14. Gjykata gjithashtu vlerësoi se i Padituri e ka zbatuar procedurën administrative në përputhje me LPPA-në dhe dispozitat procedurale të paraparë me ligjet e veçanta, të cekur në këtë aktgjykim. Për më tepër, gjykata vlerëson se vendimi i goditur e ka formën e aktit administrativ në përputhje me nenin 47 të LPPA-së. Gjykata e vlerëson si të pabazuar pretendimin e Paditësit lidhur me mangësitë e arsyetimit të vendimit të goditur, meqenëse ai i përmban të gjitha informacionet dhe sqarimet e kërkuara me nenin 48 të LPPA-së.
15. Po ashtu, gjykata vëren se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike, e cila nuk ishte kontestuese mes palëve, siç u sqarua më lartë.
16. Përveç kësaj, gjykata vlerëson se i Padituri në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale administrative. Në rend të parë, neni 4 para. 3 të Rregullës termin “program”

e kishte përkufizuar si “një pako e fotografive lëvizëse me ose pa zë që përbën një njësi të vetme brenda orarit ose katalogjeve të programeve të vendosur nga ofruesi i shërbimit medial, forma e të cilit është e krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit televiziv. Shembuj e programeve përfshijnë filat e metrazhit të gjatë, ngjarjet sportive, komeditë, dokumentarët programet për fëmijë dhe dramat origjinale”. Kjo dispozitë vërehet se ajo është e ndarë në dy pjesë: pjesa e parë e jep definicionin e termit program, ndërsa pjesa e dytë jep shembuj të programeve. Për këtë gjykatë, shembujt e dhënë në këtë definicion nuk janë shterues, por vetëm kanë për qëllim sqarimin e termit “program”. Pra, me këtë termë mund të përshihen edhe shfaqje tjera, e jo vetëm ato të cekura në pjesën e dytë të normës së cituar. Prandaj, për këtë gjykatë, paraqitja e fotografive lëvizëse me zë brenda në të cilat janë shfaqur programi i një partie politike, paraqet program që përfshihet nga neni 4 apra. 3 i Rregullores.

17. Në anën tjetër, sipas nenit 14 para. 5 të Rregullores “*Partitë politike dhe koalicionet nuk do të jenë sponsorë të programeve audio-vizuale përveç gjatë kohës së promovimit zgjedhor në pajtim me një akt të veçantë*”. Nga kjo dispozitë kuptohet se ka qenë e ndaluar që një parti politike të sponsorizoj ndonjë program audio-vizuel. Për këtë gjykatë, nga formulimi i tillë rrjedh se për të vepruar në kundërshtim me paragrafin e cituar më lartë ka mjaftuar që një program audio-vizuel, pavarësisht a është i natyrës politike apo jo, të sponsorizohet nga një parti politike. Meqenëse Paditësi asnjëherë nuk e ka kundërshtuar se programi televiziv konkret ka qenë i sponsorizuar nga partia politike, atëherë vjen në përfundimin se ai ka vepruar në kundërshtim me paragrafin e cituar më lartë.
18. Pasojat juridike të asaj shkelje rregullohen me nenin 30 para. 1 të LKPM, sipas të cilit “*Për shkelje të kushteve të licencës, kodit të sjelljes dhe akteve tjera juridike në pajtueshmëri me këtë ligj, KPM-ja mund t’u lëshojë të licencuarve vërejtje me shkrim ose t’u shqiptojë një apo më shumë prej këtyre sanksioneve: (...)*”. Siç vërehet, i Padituri ka pasur të drejtë të shqiptoj vërejtje, ose të shqiptoj edhe sanksione tjera më të ashpra për rastet kur një ofrues i shërbimeve mediale e shkel ndonjë akt juridik të së Paditurit.
19. Meqenëse i Padituri e ka shqiptuar sanksionin më të butë të mundshëm, atëherë gjykata vlerëson se edhe trajtimi i proporcionalitetit të tij me shkeljen është i panevojshëm.
20. Prandaj, meqenëse i Padituri ka qenë kompetent për të nxjerr vendimin e goditur, procedura që i ka paraprirë nxjerrjes së aktit administrativ të goditur është zbatuar në

tërësi sipas rregullave të procedurës administrative, duke qenë se i Padituri ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm për të gjitha çështjet relevante të rastit, duke marrë parasysh se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike, siç është sqaruar edhe në pjesën e gjendjes faktike në këtë arsyetim, gjykata vjen në përfundim se nuk është plotësuar asnjë kusht ligjore nga LPPA dhe LKA për anulimin e aktit administrativ të goditur, rrjedhimisht e refuzoi kërkesëpadinë e Paditësit.

21. Bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të LKA, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.675/22

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.